

Titulli i lëndës: SISTEMI POLITIK I BASHKIMIT EUROPIAN

Informatat themelore për lëndën

Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Sistemi Politik i BE-së
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Z
Viti i studimeve:	2024-2025
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	E hënë, 13:00, Salla 51
Mësimdhënësi:	Prof. Asoc. Dr. Arben Fetoshi
Të dhënat kontaktuese:	arben.fetoshi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	“Sistemi Politik i BE-së” ofron njohuri solide për institucionet, vlerat fundamentale dhe karakterin <i>sui generis</i> të Bashkimit Europian. Përmbajtja është bazuar në bibliografi të autorëve perëndimorë dhe në studimet e autorëve shqiptarë për rolin e mediave në procesin e Integrimit Europian, me një strukturim të përshtatshëm për studentët e nivelit Bachelor. Duke shqyrtuar historinë e suksesit dhe sfidat aktuale të BE-së, strukturën e saj organizative, marrëdhëniet me qytetarët europianë, si dhe Politikën e Zgjerimit, përkatësisht kriteret që duhet t’i përmbushin vendet candidate për anëtarësim, studentët do të pajisen me dije teorike dhe analitike për procesin e Integrimit Europian dhe pozitën e Kosovës në këtë proces. Meqenëse Integrimi Europian është objektiv strategjik i vendit tonë, temat janë përcaktuar në funksion të studimeve të Gazetarisë, duke fokusuar politikën mediale të BE-së dhe përgjegjësinë shoqërore të mediave të Kosovës në këtë proces.

Qëllimet e lëndës:	Nëpërmjet ligjëratave dhe detyrave në ushtrime studentët do të arrijnë ta njohin mirë sistemin politik të BE-së, rolin dhe rëndësinë e mediave në procesin e Integritetit Europian, si dhe kriteret që derivojnë nga standardi evropian për mediat. Njohja me karakterin sui generis, mënyrën e funksionimit dhe relacionet në kuadër të Politikës së Zgjerimit, do t'u ndihmojë studentëve për përgatitjen sa më të mirë dhe aplikimin efektiv të njohurive në punën profesionale.
--------------------	---

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studentët do të jenë në gjendje të:
	- Identifikojnë dhe shpjegojnë konceptet kryesore politike e juridike në Sistemin Politik të BE-së; - Njohin dhe përshkruajnë mënyrën dhe parimet e funksionimit të BE-së; - Analizojnë, vlerësojnë dhe krahasojnë sfidat e kriteret në procesin e Integritetit Europian.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15	30
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	2	1	2
Konsultime me mësimdhënësin	30 min.	15	7.5
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	10	2	20
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja për provimin final	4	1	4
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	2	2

Projektet, prezantimet, etj.	1	2	2
Total			127.5
Metodat e mësimdhënies:	Lënda “Sistemi Politik i BE-së” do të zhvillohet me metodë të kombinuar që përmban ligjërata të përgatitura paraprakisht, diskutime në formë debati dhe prezantime nga studentët.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve do të bëhet në bazë të formulës së mëposhtme: 1. Pjesëmarrja aktive 10 % 2. Ushtrime (detyrat) 15 % 3. Kolofiumi / Seminari 20 % 4. Simulimi 10 % 5. Provimit përfundimtar 45 % TOTALI: 100 % • Pjesëmarrja nuk nënkupton vetëm vijueshmërinë, studentët do të vlerësohen në bazë të cilësisë së komenteve, vëmendjes, qëndrimit dhe sjelljes në klasë. • Në kuadër të ushtrimeve studentët janë të obliguar që t’i realizojnë detyrat individuale ose në grupe si: Analizë / Ese /. Seminari është punim hulumtues për një temë të caktuar, të cilin studenti e dorëzon deri në fund të semestrit.		
Literatura primare:	1. Fetoshi, Arben. (2018). Media dhe Integrimi European, Orfeu, Prishtinë 2. Pascal Fontaine, Europa në 12 leksione, 2011, https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/04/Evropa-ne-12-leksione.pdf 3. Hix, Simon. (2011). The political system of the European Union, Third Edition, palgrave macmillan		
Literatura shtesë:	1. Bogdani, M. & Loughin, J. (2007). Albania and the European Union, L.B. Tauris 2. Soin, Robert. (2008). Evropa Politike, Papirus, Tiranë 3. D’Arcy, François. (2007). Politikat e Bashkimit Evropian, Papirus, Tiranë		

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Bashkimi Europian <i>(historia, qëllimi, struktura organizative dhe sistemi politik)</i>
Java 2:	Institucionet e BE-së <i>(përbërja, kompetencat, vendimmarrja)</i>
Java 3:	Integrimi Europian <i>(koncepti, perspektivat teorike, sfidat aktuale dhe rëndësia)</i>
Java 4:	Politika e Zgjerimit <i>(BE nga 6 në 28 / 27, Brexit, Ballkani Perëndimor)</i>
Java 5:	Kriteret e Kopenhagës <i>(Procesi i anëtarësimit, MSA, instrumentet e monitorimit)</i>
Java 6:	Kosova në procesin e Integritimit Europian <i>(Korniza ndaj Kosovës para 2008, Liberalizimi i Vizave, MSA)</i>
Java 7:	Testi Intermediar
Java 8:	Politika mediale e BE-së <i>(Direktiva për Shërbimet Mediale Audiovizuele, Karta Europiane mbi Lirinë e Shtypit, EBU)</i>
Java 9:	Mediat si kriter për vendet e zgjerimit <i>(Liria dhe pluralizmi i mediave, koncentrimi dhe parimet etike)</i>
Java 10:	Roli i mediave në Procesin e Integritimit Europian <i>(Roli (dez)integrues dhe Opinionbërës)</i>

	<i>Rasti i Kosovës: roli informativ e edukativ)</i>
Java 11:	Komunikimi si <i>Strategji</i> në procesin e Integrimit European (<i>Strategjitë e Komunikimit të Kroacisë, Malit të Zi, Shqipërisë dhe Kosovës</i>)
Java 12:	Rruga e Kosovës drejt BE-së (<i>Sfidat dhe mundësitë – Dialogu për normalizimin e raporteve Kosovë-Serbi</i>)
Java 13:	Bashkimi European në skenën botërore (<i>Politika e Përbashkët dhe e Sigurisë, Roli Ndërkombëtar dhe Tregtia</i>)
Java 14:	BE-ja në kontekstin e luftës Rusi-Ukrainë (<i>Politika e përbashkët e sigurisë dhe implikimet gjeopolitike</i>)
Java 15:	Diskutim përmbledhës për lëndën

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën në heshtje për të marrë shënime; aktivitete të tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi. Nga të gjithë pritet të jenë të sjellshëm dhe të respektueshëm ndaj të tjerëve gjatë diskutimeve, dhe nuk bënë të përdorët gjuhë e pahijshme. Studentët janë të obliguar t'i vijnë ligjëratat dhe ushtrimet. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe janë pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit.